



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1755 Prot.

Roskovec, më 08, 08 2025

VENDIM

NR 9 .DATË 28.02 .2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN JANAR 2025”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.01.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1755 Prot.

Roskovec, më 09, 09 2025

VENDIM

NR 9 .DATË 28.02 .2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT  
BASHKIAK PËR MUAJIN JANAR 2025”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

**VENDOSI :**

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 29.01.2025, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2025.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Afrim Plaka**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 758/1 Prot.

Roskovec, më 30.01.2025

Procesverbal Nr.1

*-I mbajtur sot, datë 29.01.2025, ora 13<sup>00</sup>, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite :*

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2024.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2024.
5. Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2025.
6. Për miratimin e Këshillit Ekonomik në Bashkinë Roskovec.
7. Për miratim të projekteve prioritare për Bashkinë Roskovec.
8. Për miratimin e ndihmës nga fondi i kushtëzuar për djegien e banesës së Z.Shpëtim Kuqo në fshatin Vidhisht, Njësia Administrative Kuman, Bashkia Roskovec për vitin 2025.
9. Për miratimin e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2025-2030.
10. Për miratimin e bashkëfinancimit për programet e strehimit social.
11. Për miratimin e listës së përfituesve nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”.
12. Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2025.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13<sup>10</sup>

Këshilltarët prezent: A.Plaka, E.Çepele, F.Hoxha, L.Goga, E.Buzi, E.Kaçeli, N.Zeka, H.Hajdini, Dh.Malka, A.Hoxha, V.Çepele, F.Feleqi.

Këshilltarët që mungojnë: A.Lamaj, Rr.Hazizi, E.Toska, E.Xhaxhaj, J.Begaj, P.Toro, A.Pelo, S.Bibo Qamili, Zh.Metushi.

Prezent nga bashkia: Nënkryetari M.Goga, Dr.Ekonomik S.Çepele, Dr.Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit E.Hoxha,, P/Shërbimit Social S.Saliaj, Dr.Integritimit Europian E.Shehu.

Me plotësimin e kuorumit, Kryetari hap mbledhjen. Prezent në fillimin e mbledhjes janë 12 këshilltar. Kryetari – Përfitoj nga rasti që në mbledhjen e parë tju uroj një vit të mbarë në familjet tuaja dhe në punën tonë si Këshill, gjithashtu dhe gjithë qytetarëve, meqënëse është hera e parë që kam mundësinë që të komunikoj me ta nëpërmjet këtij formati. Ju falenderoj të gjithëve që jeni bërë pjesë e mbledhjes, përpara se të kalojë në procedurë Z.Maksi Nënkryetari i bashkisë kërkon fjalën për të bërë një falenderim. Maksi- dua nga ana ime në emër të Ekzekutivit të bashkisë do tju uroj një vit të ri kalendarik 2025 sa më të mbarë për ju si Këshill bashkie, mbarësi paçi në familje dhe mbarësi në vendimmarrje për komunitetin tonë. Kryetari- të nderuar këshilltar siç jeni njohur me rendin e ditës të parashikuar për mbledhjen e sotme, të shpërndarë tek ju në datën 23.01.2025, do doja tju njoftoja për dy ndryshime në lidhje me rendin për të cilin ju jeni njohur paraprakisht. Ndryshimi i parë ka të bëjë me pikën 8 të rendit të ditës që është “Për miratimin e ndihmës nga fondi i kushtëzuar për djegien e banesës së Z.Shpëtim Kuqo në fshatin Vidhisht,Njësia Administrative Kuman,Bashkia Roskovec për vitin 2025”, kemi vetëm një ndryshim në titullin e këtij projekt-vendimi “Për miratimin e ndihmës për djegien e banesës së Z.Shpëtim Kuqo..”, pra bie tog fjalëshi “nga fondi i kushtëzuar” sepse fondi i kushtëzuar është një fond i cili nuk është lëvruar akoma dhe për këtë arsye nuk do të përdoret ky si fond, por do të përdoret një fond tjetër nga bashkia Roskovec për dhënien e kësaj ndihme. Gjithashtu do doja tju njoftoja se për të njëjtën arsye projekt-vendimi “Për miratim të përdorimit të fondit të emergjencave civile për vitin 2025”nuk do të shqyrtohet në këtë mbledhje për të njëjtën arsye që ju thashë, pra hiqet fare nga rendi i ditës pika 12. Fredi- ne si Këshill kemi lënë për pyetje ose për hallet e komunitetit pikën e fundit të rendit të ditës, nuk jam për të ndryshuar por unë kam një mendim, që të gjitha shqetësimet e komunitetit të lihen në pikën e parë të rendit të ditës gjatë çdo mbledhje, sepse pika e fundit e rendit të ditës njëri ikën, Kryetarja mbase ikën sepse ka probleme është e angazhuar diku tjetër. Të vihet në pikën e parë të rendit të ditës, nuk kam asnjë gjë të keqe por kujtojnë sikur i lëmë ata të komunitetit në pikën e fundit dhe nuk i kushtojmë rëndësi, nuk kam asnjë gjë por vetëm me qëllimin e mirë, edhe njerzit që vijnë aty të vijnë në pikën e parë të rendit të ditës dhe të ikin. Nuk ka asnjë gjë nuk dua të më keqkuptosh, jo për sot për mbledhjet e tjera në vazhdim, ta bëjmë si rregull që në pikën e parë të rendit tua çojmë atyre, sepse edhe ata rrinë aty 4 orë për një problem që ka në fund ai, e miratojmë pikën e parë të gjitha shqetësimet e komunitetit, kaq kisha. Kryetari-faleminderit, unë do doja tju kujtoja që në një pjesë të mbledhjeve një pjesë e këshilltarëve nuk kanë pasur durimin që ti ndjekin vet deri në fund mbledhjet, do ishte mirë që ti ndjekin sepse pavarsisht janë dakort apo nuk janë dakort me vendimmarrjen e shumicës në këtë Këshill, ata kanë marr përsipër ti përfaqësojnë në çdo pikë të rendit të ditës qytetarët. Përsa i takon kërkesës tuaj përgjigja ime është kjo, në qoftë se e keni parë me kujdes rregulloren, kjo mënyrë renditje pra përcaktimi i piketave që është miratimi i rendit të ditës, informacion mbi vendimet e Këshillit dhe pika e fundit diskutime dhe komente të qytetarëve është përcaktuar në rregullore dhe është e paraparë në format kështu. Ju gjithmonë keni disa kërkesa që mundoheni ti arsyetoni në mënyrën tuaj me të drejtë, por unë sot nuk mund tju jap një përgjigje pa diskutuar dhe ligjërisht nëse është e mundur që ne ta ndryshojmë dhe rregulloren dhe ta bëjmë. Dhurata-po ska asgjë të keqe. Kryetari-të lutem tani se unë nuk po diskutoj ka apo ska të keqe sepse parimisht mund të ngrihet çdo lloj pretendimi, por ligji nuk është se të lejon se meqënëse parimisht e gjen të drejtë diçka, duhet ta ndryshosh patjetër, përgjigja që unë ju dhashë për sot ishte kjo. Fredi- unë spo them për sot, por ta kemi se nuk ka asnjë shkelje ligjore edhe qëllimin e mirë e ka sepse unë vet kam ikur në pikën e

fundit të rendit të ditës, nuk e kam ndjekur për angazhime të tjera, por ta shikojmë me seriozitet. Kryetari-do ta shikoj me vëmendje dhe do të jap një përgjigje. Maksi-unë jam dakort që mund të diskutohet në pikën e parë të rendit të ditës, gjithmonë sipas rregullores por dhe me kushtin që në mbledhjen e grupit të këshilltarëve të dimë çka pikash do futen për diskutim me qytetarët, në qoftë se ka problematika të arshivuara brenda muajit hajt ti diskutojmë të japim dhe informacion, në qoftë se ka problematika por jo çdo lloj problematike që mund të vij nga qytetarët. Dhurata- por ne mund të ngrejme një shqetësim, një,dy,tre shqetësime që i transmetojmë. Maksi-ler të mblidhen Kryetarët e grupeve ta vendosin por gjithmonë me problematikat që kanë ardhur të arshivuara. Fredi-po siç kemi bërë, vetem ndryshimin e rendit të ditës. Dhurata-ai po thotë të paraqiten paraprakisht, të paraqitet kërkesa kur të mblidhet grupi. Kryetari- ftoj anëtarët e Kryesisë që të jenë pjesëmarrës në mbledhje për ti diskutuar që atje, pra atje është momenti kur ne vendosim rendin e ditës. Ju falenderoj për atë çka na sollët në vëmendje, ka dikush nevojë të marrim fjalën për procedurë, apo të vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës? Nuk ka më diskutime.

### 1.Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

Kryetari hedh në votim rendin e ditës me dy ndryshimet e diskutuara si më sipër për pikën 8 dhe 12 të rendit të ditës dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

### 2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Dhjetor 2024.

Sekretarja e Këshillit sqaron informacionin në lidhje me vendimet e miratuara mbledhjen e muajit Dhjetor, tre vendimet normative të dërguara në Prefekturë si dhe miratimin e tyre nga Prefektura. Të gjitha vendimet janë shpërndarë në zyrat përkatëse për zbatim.

### 3.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.

Kryetari hedh në votim procesverbalin e mbledhjes së kaluar dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

### 4.Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Dhjetor 2024.

P/Shërbimit Social Sidorela sqaron projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur.Kemi ndryshime në dy njësi, në Njësinë Kuman dhe Roskovec, janë hequr nga një familje dhe janë shtuar familje të reja. Amarildo-të njëjtët janë sërish? Sidorela- të njëjtët janë por në dy njësi janë hequr dy familje dhe janë shtuar dy të reja. Amarildo-çka problemi kanë pasur që janë hequr dy familje, kanë plotësuar kriteret apo..Sidorela-kanë ndryshime në situatën social-ekonomike, janë punësuar. Amarildo-familjet e reja që janë futur besoj i plotësojnë kriteret ?Sidorela-po. Amarildo-ta kalojmë, nuk është nevoja një gjë që e kemi bërë disa herë. Dhurata-në lidhje me projekt-vendimin jam dakort absolutisht që do ta kalojmë, por kisha një pyetje se ne si grup në mbledhjen e muajit Nëntor kërkuam të bëhej transparente lista e personave që marrin ndihmë ekonomike, ju na premtuat që së shpejti do e nxirrnit, madje në Dhjetor do e shpallnit ose do na e sillnit ne ta shikonim, dhe ne tani doli dhe muaji Janar dhe ne akoma se dimë se cila është lista emërore dhe sa

është numri, se na premtuat që do na e sillnit. Sidorela-i kam publikuar nëpër njësi. Dhurata-se unë kam kërkuar atje dhe sma kanë dhënë, ju thashë dhe ju më thatë mos kini merak se do e sjellim në mbledhjen e radhës, në Dhjetor kaloi si kaloi situata, kur do ta kemi në një listë ta shohim sa është numri, cilët janë personat të cilët marrin ndihmë ekonomike? Sidorela-do ta publikojmë. Dhurata-pse mos të bëhet publike, çtë keqe ka ta dimë? Kryetari-të nderuar këshilltar specialistja më thotë që sot përpara përfundimit të mbledhjes, mund të pajiseni me një kopje të listës së personave. Dhurata-ok, faleminderit. Nuk ka më diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

5. Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për bllok-ndihmën për vitin 2025.

Dhurata-kriteret i kemi lexuar. Kryetari-pra këto janë kriteret ku bazohet administrata për të përcaktuar familjet që futen në këtë skemë. Fredi-ça rëndësie ka kjo që të kalojë sepse ato kanë qënë kriteret? Sidorela-kalojnë çdo vit. Fredi- a kalojnë formalisht, dakort. Kryetari-keni pasur kohën që të njiheni me këtë projekt-vendim, kërkon njeri fjalën për pyetje, për diskutime në lidhje me projekt-vendimin? Nuk ka pyetje dhe diskutime për këtë projekt-vendim. Kryetari e hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro.

6. Për miratimin e Këshillit Ekonomik në Bashkinë Roskovec.

Dr. Integriti Europian E. Shehu sqaron projekt-vendimin dhe relacionin sipas materjalit që këshilltarët kanë. Dhurata-në pikën 5 ne miratim disa kriterë për familjet të cilat trajtoheshin me ndihmë ekonomike, tani jemi tek pika 6 e cila thotë për miratimin e Këshillit Ekonomik në bashkinë Roskovec, a ka disa kriterë që janë përzgjedhur këta persona, këta individ, këto biznese? Enirjeta-patjetër që ka, po të shikojmë në faqen zyrtare të bashkisë Roskovec është bërë publikimi për të shprehur interesin gjithë bizneset që duan të jenë pjesë. Kryesorja është që duhet të jenë regjistruar si biznese, të jenë në territorin e bashkisë Roskovec dhe të mos jenë të dënuar, këto janë kriteret. Dhurata-ska kriterë të tjera, as arsimi ska të bëj, pranohen dhe pa arsim? Sepse disa prej tyre pa dashur ti fyej por janë pa arsimin përkatës, ata as 8-vjeçaren nuk kanë mbaruar, nja 3-4 veta nga këta. Enirjeta-qëllimi kryesor i këtij Këshilli Ekonomik është përfshirja e bizneseve dhe jo të përzgjedhim individ. Dhurata-po e drejtojnë dot, a ka mundësi një njeri i pa informuar, i pa arsimuar të drejtojë një konferencë, të marrë dhe të japë këshillime, mundet sipas jush? Enirjeta-ai kërkon informacione shtesë. Dhurata-si kërkon, kush kërkon, po dhe do drejtojnë konferenca apo jo? Enirjeta- Këshilli është i përfaqësuar dhe nga specialistët të bashkisë Roskovec. Dhurata-po këta të tjerët apo do jenë kështu sa për të mbushur sallën, këta duhet të jenë drejtues apo jo? Enirjeta-problematikat e biznesit shprehen nga vet ata që drejtojnë një biznes, nuk mund të shprehet një problematikë e biznesit, për tu hedhur për diskutim dhe miratim në konferenca apo tryeza të ndryshme diskutimi, sepse vet specialistët e fushës që ne kemi në bashki apo kudo qoftë.. Dhurata-drejtojnë vet ata kanë nevojë, këta vetëm sa për kështu.. Enirjeta-jo, problematikat i dinë ata nuk i dimë ne. Dhurata-cilët? Enirjeta-problematikat e bizneseve. Dhurata-i dinë ata? Enirjeta-po patjetër që biznesi i di problematikat e veta, nuk i dimë ne. Dhurata-sepse aty është shkruar që marrin pjesë në konferenca, drejtojnë dhe udhëheqin, marrin sugjerime nga komuniteti prandaj thashë unë. Enirjeta-Këshilli Ekonomik në tërësi, nuk është specifikisht. Viola-a ka një buxhet të përcaktuar

paraprakisht që do përdori ky Këshill për çdo organizim që do bëhet? Enirjeta-Këshilli Ekonomik është në mënyrë vullnetare, nga bashkia nuk ka një buxhet të përcaktuar për këtë Këshill, edhe nga bizneset nuk ka detyrim financiar, që janë të përfshirë në këtë organizëm. Amarildo-shohim këtu një pjesë të biznesmenëve, nuk ka rëndësi se ata janë njerëz të nderuar në punën e tyre, po në zonën tonë ka biznese shumë më të suksesshme seç janë këta zotrinjtë këtu, që kanë dhe një formim disa janë dhe ekonomistë të mirfilltë dhe nuk i shoh të përfshirë, besoj se informimi nuk do jetë bërë i saktë për mendimin tim, përderisa janë 2-3 të paktën subjekte që janë biznese të mëdha dhe nuk janë përfshirë, shikoj që nuk është bërë informimi i duhur. E dyta do doja që përderisa është pjesë e një Këshilli Ekonomik duhet të kishte dhe specialist që të mos ishin pjesë e biznesit, por të jenë individ që punojnë në fushën e duhur, jo përfaqësues të institucionit të bashkisë, ler të jetë përfaqësuesi i bashkisë por duhet të jetë nga shoqëria civile, këtë mendim kisha. Enirjeta-po të shikojmë një nga anëtarët e Këshillit Ekonomik është Ronada Hoxha, që është drejtuese ekzekutive e një prej organizatave që kryen funksionin në territorin e bashkisë Roskovec, pjesa tjetër do të thoja që Këshilli Ekonomik nuk është se nuk ka të drejtë njeri tjetër ose individ tjetër që të shprehë interesin për tu bërë pjesë e anëtarëve të Këshillit Ekonomik, ne miratojmë pjesën e parë që ju kemi paraqitur, në qoftë se do kemi kërkesa të reja ne i fusim në listë dhe ata shtohen. Amarildo-disa biznese që kanë edhe ekonomist brenda biznesit të tyre nuk janë përfshirë, dhe është e dukshme qartësisht që ka qënë politike përzgjedhja, se e shikojmë nuk është nevoja të përmendim emra, se ne e njohim zonën tonë i dimë dhe bizneset, këtu janë 3 biznese të mirëfilltë, biznese të mëdhenj që nuk kanë lidhje fare me asnjë nga këta zotrinjtë këtu dhe nuk është askush i përfshirë, kjo është e qartë që është politike. Enirjeta- nuk është politike, janë të lirë të shprehin interesin e tyre me një kërkesë pranë bashkisë. Amarildo- duke i ftuar bashkia, bashkia ka detyrimin ti bëjë ftesën. Enirjeta-ne bëjmë njoftimin nuk bëjmë ftesën. Amarildo-pikërisht ti bëjë njoftimin, dhe në rast se ai nuk e pranon është pjesë e tij, por ju nuk e besoj ta keni bërë njoftimin, kam konfirmuar që dy biznese deri tani nuk e kanë marrë njoftimin, janë të painformuar. Enirjeta-njoftimi bëhet në faqen zyrtare dhe jo individualisht. Amarildo-tani bizneset nuk do rrinë të shikojnë faqen zyrtare të bashkisë se nuk kanë kohë të merren me faqen zyrtare të fotove të pemëve të bashkisë, kanë bizneset e tyre. Enirjeta-çdo biznes është i lirë të shprehë interesin dhe të bëhet pjesë e këtij Këshilli. Amarildo-pikërisht por duke u ftuar nga bashkia, duke i bërë një ftesë, pastaj është pjesë e tij e pranon ose jo për të qënë përfaqësues. Enirjeta-shprehja e interesit është publike kështu që të gjithë mund të jenë pjesë. Fredi-kush jeni ju që zgjidhni Këshillin e bizneseve, bashkia ç'punë ka me Këshillin e bizneseve? Këshilli i biznesit zgjidhet në qoftë se i duhet bashkisë, bën njoftimin, organizohet vet Këshilli i biznesit, zgjedhin vet përfaqësuesin e pastaj bashkia i bashkangjit specialistin Selman Çepele, Ronada Hoxha, Orgesa Goga edhe ndonjë dëshirë që ka Kryetarja tjetër, por absolutisht është edhe pa moral edhe pa ligj që të zgjedhi Kryetarja e bashkisë Këshillin Ekonomik, se e ka zgjedhur ajo. Vjet na zgjodhi Odën e Fermerit znj. Kryetare ata që deshi, i përjashtoi edhe nga taksat nga tarifatat, ca që bëjnë një biznes të dytë 200 milion lekë i përjashtoi edhe nga tarifatat, e kupton kjo është turp i madh. Nuk kemi punë ne, as ne si Këshill as ju si bashki të përzgjedhim Këshillin Ekonomik të biznesit. Biznesi organizohet në qoftë se ju duhen, bashkia bën njoftimin se skanë të gjithë rrjete sociale, merrni një përfaqësi, të lajmërohen të gjithë ose në televizionet lokale ose ku të doni ju, e zgjedhin vet që të ketë moral ky Këshill. Si zgjidhen këtu 5 veta që do Kryetarja e bashkisë, e kupton si është? Është turp, ka nja 400 veta që i ka marrë Kryetarja si i ka dashur qejfi, edhe Këshillin Ekonomik do marrë si i do qejfi? Enirjeta- për atë çfarë ju diskutuat që Këshilli Ekonomik duhet të mblidhet dhe duhet të organizohet, në rastin

konkret në qoftë se ata do të mbledhen vet, do të funksionojnë si një organ i posaçëm që kanë detyrime ligjore, financiare e të gjitha me radhë. Në këtë rast sipas kësaj procedure që ne kemi ndjekur, bashkia është pjesë e një programi i cili financohet nga Bashkimi Europian dhe i jep mundësinë bashkisë të jetë miqësore me biznesin. Që të jemi pjesë e këtij programi ne duhet të kemi dhe krijimin e Këshillit Ekonomik sipas një procedure ligjore që është miratuar tashmë, jo nga bashkia, është procedure ligjore që është miratuar nga institucionet e tjera dhe kemi arritur deri në këtë fazë shpalljet publike, pra të gjithë bizneset që janë të interesuar mund të bëhen pjesë e këtij grupi dhe pjesa e specialistëve të fushës është për ti ndihmuar dhe lehtësuar gjithë procesin që do të jetë në vijim. Nuk ka më pyetje. Kryetari pyet kush ka diskutime? Fredi-unë e kam mendimin që ta lëmë për mbledhjen tjetër, në një televizion lokal ose në rrjetet sociale tu japim hapsirë të gjithë bizneseve të vetzgjidhen pavarësisht se e kërkon edhe ligji, nuk është e thënë që ti zgjedhi Kryetarja e bashkisë. Enirjeta-nuk është zgjedhur, shprehin interesin, janë të lirë të shtohen dhe të bëhen pjesë e këtij grupi duke shtuar numrin. Fredi- ne e dimë përzgjedhjen, sinqerisht e dimë përzgjedhjen. Enirjeta-unë flas procedurat ligjore. Fredi- po lëri procedurat ligjore, për çka e keni sjellë këtu në Këshill? Enirjeta- për të miratuar..Fredi-atëherë dhe unë që ta miratoj duhet të kem këtë që po them, ta lëmë për mbledhjen tjetër, të informohen të gjithë bizneset, mbase kanë dëshirë, mbase këta dalin prapë që kanë dëshirë e kupton? Unë e di mënyrën e përzgjedhjes së znj. Kryetare, njërin e kam kunatin tim, problemi është këtu që të ketë moral, se ky do dhe një buxhet pastaj më mbrapa, sdo për momentin ai por duhet konferenca. Enirjeta-jo nuk do. Fredi-po këtu do jemi prapë, do dalin ata në konferencë, do venë gjëkund ata, sa për mjedisin që të kujdesen dhe për mjedisin na e ka bërë peshqesh Kryetarja termocentralin, biles njëri nga ata e ka 800 m afër shtëpisë së tij, ta dijë ai që ka dorë edhe për mjedisin, ai kunati im e ka 800 m. Dhurata- ai 600 m, 800 m e kam unë. Fredi-këto janë llaflollogjira, këto duhen ligjërisht por këto nuk kanë moral, nuk kanë ligjore që të bëhet diçka që ne të vijmë ta miratojmë, të dimë, edhe ata ta dinë se 99% se dinë fare, ta lëmë për mbledhjen e ardhëshme, tu japim hapsirë gjithë bizneseve edhe ata të vetofrohen, vetzgjidhen, të krijojnë edhe ata, të paraqiten vet. Amarildo-ju si institucion keni detyrimin ti njoftoni, bëni njoftimin e gjithë bizneseve dhe pastaj është pjesë e tyre se çka do bëjnë. Enirjeta-nuk ka kufizime të bizneseve, që ne miratojmë listën sot dhe ka kufizime që nuk do ketë biznese të tjera që shprehin interesin dhe të bëhen pjesë e grupit, po keqkuptohemi këtu, shtohen dhe kanë të drejtë që të zgjidhen çdo 4 vite. Amarildo- nuk ka pse të shtohen, bëni njoftimin siç është për tu kryer nga ana juaj. Enirjeta- njoftimi dhe procedura ligjore është tek faqja zyrtare e bashkisë Roskovec. Amarildo-në rast se kemi 200 biznese të regjistruar dhe në rast se sillni sërish këta, këta do miratojmë, por ua garantoj që dhe këta që keni sjell nuk janë të informuar që janë pjesë e kësaj liste, një pjesë e mirë e këtyre po të telefonojmë nuk do jenë të informuar që janë pjesë e kësaj liste, e këtij Këshilli ua garantoj me bindje. Enirjeta-në qoftë se ne bëjmë njoftim në televizionet lokale ka kosto shtesë për bashkinë. Fredi-po mirë, ne po miratojmë miliona, kostoja e një televizioni lokal e ka maksimalisht 100 mijë lekë të vjetra, për aq problem bëjmë ne këtu dhe të miratojmë këtu llaflollogjira gjëra koti. Enirjeta-faqja zyrtare është që ne bëjmë njoftimin. Fredi-kush ka faqe zyrtare, bizneset nuk kanë të gjitha imeile, facebook, po lëre tani të gjithë do futen tek faqja zyrtare, në qoftë se sdoni ta bëni mos e bëni, ne nuk jemi dakort. Enirjeta-nuk janë të kufizuar, çdo biznes mund të shprehi interesin. Fredi- po lëri llaflollogjirat, ashtu siç bëtë për Odën e Fermerit. Kryetari-po ti referohemi ligjit, ligji i ka përcaktuar rrugët me anë të të cilit shpërndahe dhe publikohet informacioni, por kam një pyetje, keni 5 ditë që i keni marr materialet dhe besoj që keni pasur mundësi të flisni dhe me biznese të ndryshme, keni ndonjë emër konkret i cili është



vërtet i interesuar sepse kjo është ndërmarrje vullnetare me kërkesë nga i interesuari, nuk është me përcaktim nga bashkia. Keni ndonjë rast të ndonjë biznesmeni i cili ka dëshirë që të jetë pjesë e listës apo thjesht po hamendësoni që mund të jetë kështu? Fredi-jo nuk hamendësojmë fare. Kryetari-jo është pyetje e dretjepërdrejtë, keni ndonjë? Ju si këshilltar keni marr këtë informacion para 5 ditësh dhe po ju pyes prapë..Amarildo-nuk është detyrimi jonë ti njoftojmë ne bizneset. Kryetari-po nuk është por po ju pyes keni ndonjë rast, që nuk është detyrimi jonë kjo mua nuk më qëndron drejtë sepse ne kemi për detyrë ti informojmë. Fredi-unë kuptoj edhe këmbnguljen tuaj z.Kryetar i Këshillit që të mos dalësh nga rendi. Dhurata-kemi edhe ne një pyetje,po ju keni folur me ata persona vet? Kryetari-unë po, unë provova të flas me nja dy biznese që janë në zonën ku unë jetoj, nuk ishin të interesuar të merrnin pjesë, dhe po ju pyes keni pas ndonjë rast ju që ka pas dëshirë kaq të madhe për të ardhur në Këshillin Ekonomik? Dhurata-jo unë thashë këta që janë të përzgjedhur këtu, ishin dakort? Kryetari-detyrimin për shpërndarjen e informacionit e keni edhe ju. Amarildo-pse e keni kaq me ngut, e kalojmë herës tjetër, bëni një njoftim siç është për tu kryer, edhe në rast se ju sillni sërish këta ne do ta kalojmë. Fredi-nuk është ndonjë problem z.Kryetar, ne jemi prapë këtu. Maksipropozimi juaj mbase ka vend në qoftë se do të kishte ndonjë bazë që kemi fermer ose biznesmen të tjerë që duan të futen në listë, lista është e hapur, ne jemi plotësisht dakort që kushdo që ka interes qoftë dhe marrjen e indicios nga kjo mbledhje e Këshillit, nga kjo vendimmarrje të futet në listë dhe numri nga 13 mund të bëhet dhe 21, ska asnjë lloj problemi për ne. Fredi-po çka problemi ka nëse e lëmë mbledhjen tjetër? Maksijanë ca detyrime ligjore që këto organizata..Fredi-unë e kuptojë shumë drejtë, ju nuk dilni dot nga rendi i ditës që ua ka thënë Kryetarja e bashkisë, absolutisht nuk keni asnjë problem tjetër. Maksikë doni ju e shtojmë. Amarildo-po jo kë duam ne, ata janë biznese pse ne i kemi në dorë ata? Thjesht bëni njoftimin kaq po ju kërkojmë. Maksieshtë bërë njoftimi. Amarildo-Maksi po e zgjasim kot, tani do ti them me emra bizneset këtu? Fredi-ça po zgjedhim këtu, unë se kuptoj çka po zgjedhim? Maksipo krijojmë Këshillin Ekonomik. Fredi-po e miratojmë atë që ka zgjedhur Kryetarja. Amarildo-Maksi edhe një herë se po e zgjasim kot, nuk është asgjë thjesht bëni njoftimin. Enirjeta-njoftimi është bërë sipas procedurës ligjore. Amarildo-jo në faqe se e dëgjova atë pjesë, mos e diskuto atë pjesën e faqes zyrtare, njoftoni bizneset nuk ka asgjë, një kartolinë i dërgoni dhe i thoni zotëri i dashur : kemi hapur një Këshill atje në bashki, dëshironi që të antarësoheni? Kaq. Në rast se ai ju kthen përgjigje negative, mbaroi. Maksidhe po u miratua e bëjmë prapë përsëri këtë që thoni ju dhe e shtojmë në Këshill. Amarildo-Maksi tani doni ta kaloni e kaloni vet, nuk është problem. Elmazi-duke dëgjuar dhe duke shikuar materjalin të cilin kam përpara, jam dakort me parafolësit nëse lista do ishte e mbyllur dhe nuk kishte të drejtën e shtesës, nuk duhet të kalonte. Derisa lista është e hapur dhe këtu mund të venë 20 apo 30, nuk ka pse ne hidhemi është njoftuar Elmazi apo është njoftuar Afrimi, kjo është këtu ti qëndrojmë kësaj dhe e votojmë këtë materjal dhe kush ka dëshirë nga të tërë ata, ndoshta është dhe ajo që thotë ai që ka dhe njerëz që nuk janë informuar, le të gjendet një rrugë të informohet, duhet të shkruhet që mbetet e hapur të shtohet kushdo, prandaj hidhe në votë. Kryetari-të nderuar këshilltar në përfundim të këtij diskutimi që bëm dhe mendimeve me vlerë që dolën nga të dy grupet përfaqësuese këtu, unë ju ftoj të votoni projekt-vendimin “Për miratimin e Këshillit Ekonomik në Bashkinë Roskovec” me kushtin që kjo listë mund të plotësohet në vazhdimësi me biznese të cilat do të shprehin interesin për të qënë pjesë e kësaj liste. Hidhet në votim projekt-vendimi si më sipër dhe miratohet me 8 vota pro, 4 vota kundër Dh.Malka,F.Feleqi,A.Hoxha,V.Çepele.

## 7.Për miratim të projekteve prioritare për Bashkinë Roskovec.

Dr.PZHTMP Eneida- të nderuar këshilltar si çdo vit Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Mjedisit dhe Pronës harton listat me projektet prioritare, të cilat synojmë të zhvillojmë gjatë vitit, kjo për arsye se në disa thirrje ne e kemi kusht që ti kemi të vendosura si projekte prioritare, pra në qoftë se aplikojmë për thirrje të ndryshme gjatë vitit, duhet ta kemi parashikuar si projekt prioritar në Këshill. Projektet janë 30, nëse doni i lexojë. Dhurata-jo ska nevojë se i kemi lexuar. Kryetari-atëherë fjalën për pyetje kush e kërkon? Dhurata-një pyetje kisha, në vitet e kaluara kemi miratuar një projekt-vendim për shtrimin e rrugëve përgjithësisht, aktualisht po shtrihet rruga e Kaminës në fshatin Suk 1 dhe ka gati 5 ditë që po shoh që ata po e ngjeshin atë rrugën atje. Tani pse nuk ka një tabelë atje të informohemi ne qytetarët aty, sa është fondi, kur fillon kjo rrugë, kur mbaron, e para kjo. E dyta këtu janë hedhur 30 projekte prioritare dhe për këto 30 projekte ok unë ju përgëzoj që i keni hedhur, a kanë një afat kohor këto se këtu nuk shoh ndonjë afat, se nuk e kam lexuar ose nuk e kam vënë re por besoj se nuk ka afat të shkruar, kur është afati i këtyre projekteve? Se zakonisht këto projekte ju i zbatoni para zgjedhjeve mesa shohim, se çdo gjë është e evidente. Pastaj nëse ndalemi sipas pikave dhe sipas këtyre projekteve prioritare që ju keni hedhur këtu, aty thuhet që do bëhet ndërtimi i kopshtit dhe çerdhes në fshatin Suk 1, për momentin atje është një qendër shëndetësore e cila është bosh pranë shkollës e dini ju të gjithë, atje do behet çerdhja sepse ajo është bosh për momentin, e kam si pyetje këtë në fakt, se kopshti është ekzistuesi, janë dy kopshte madje pranë shkollës dhe e ka godinën boll, dhe ku do shtohet se e keni hedhur si projekt, ku do zhvillohet ky projekt? Pastaj kemi atë projektin tjetër pyllëzimi i brezit të gjelbër Suk-Jagodinë-Marinëz, më kujtohet që e kemi bërë që 6-mujorin e parë kur ne u betuam në këtë sallë Këshilli, për gjelbërimin e këtyre dhe kaluan dy vite gati dhe akoma nuk është bërë asnjë gjë, domethënë i kalojmë projektet, i stërkalojmë herë pas here dhe asnjë nuk është në zbatim mesa shohim. Pastaj po të kalojmë tek pika tjetër ndriçimi që unë u bëra bozë, që çdo muaj çdo mbledhje unë e kam kërkuar këtë sistemin e ndriçimit rrugor, që z.Maksi Nënkryetari thotë Dhurata do bëhet këtë muaj, do bëhet këtë muaj dhe është i disati muaj që shtyhet, e keni hedhur prapë projekt ju këtu por shpresoj që të mos e shtyni më tani sepse e tillë është situata, duhet ndërhyrë urgjentisht,faleminderit. Eneida-sa i përket rrugës së Kaminës, rruga është në vazhdim, nuk është projekti asfaltimi i rrugës së Kaminës por është pjesë e projektit mbrojtja lumore, ku në fazën e parë janë bërë penelat në lumin Seman dhe kjo është vazhdim i këtij projekti, dhe unë sot nuk e di në qoftë se ka tabelë atje, por duhet të jetë tabela tek penelat. Dhurata-jo ska tabelë atje, dhe pse të jetë tabela tek lumi kush e shikon tek lumi? Eneida-sepse aty është nisur projekti, është një projekt. Dhurata-po kush e shikon atje pra, projekti është në vazhdim por tani kush e sheh atje anës lumit, vetëm unë që kaloj tek sera ime se askush tjetër se sheh atë, ndërkohë këtu je në kulmin e rrugës që ajo duket. Ka një datë kur fillon kur mbaron ky projekt, ndërkohë që ajo mungon aty? Kush e ka lexuar, më fal se ti banon vet andej e ke shtëpinë, as vet se di që nuk është tabela atje. Eneida-po se duhet të jetë tek panelat. Dhurata-po nuk është pra se dy ditë ka qëndruar atje e di unë, e kanë vjellur dhe askush se di, ore ka një table kur fillon kjo rruga, kur do mbaroj dhe ishalla bëhet me parametrat e duhur, se të tjerat kanë dështuar të gjitha rrugët e Sukut, i kemi parë janë mënjeluar të gjitha të shkretat, po kalojnë makinat po anojnë djathtas dhe majtas sa herë kalojnë atje, ose rruga tjetër para shkollës që është 2 metër e gjysëm, me zor se kalon një makinë se dy nuk shkëmbehen kurrë ska shance se bie në kanal, se kanalin ne e miratua këtu në Këshill me bankinë por as nuk u thellua i shkreti të kaloj uji të paktën, jo bankina dhe betoni që su bë e su bë, mos harroni të tëra

gjërat e tjera pastaj. Unë mendoj që duhet tabela atje, të informohet publiku. Eneida-po do ta shikoj. Përsa i përketë pyetjes së dytë për afatet kohore këto janë projekte të cilat kanë një projekt-ide disa, disa kanë projekte të plota. Dhurata-kur zbatohen? Eneida-këto nuk janë në proces zbatimi të gjitha, ne mund të presim edhe thirrje që i aplikojmë dhe sipas kushteve të thirrjes do të zbatohen në qoftë se i fitojmë gjithmonë. Dhurata-po më fal, po këtë ndriçimin sa herë e keni hedhur asnjëherë se keni fituar? Eneida-jo. Dhurata-po ç'a do të thotë kjo ?projekti i ndriçimit të paktën dy vjet kam unë këshilltare. Eneida-ne miratojmë projektet prioritare pastaj i aplikojmë nëpër thirrje, në qoftë se ne nuk i fitojmë thirrjet nuk na kushtëzon gjë që ti kemi prapë gati për thirrje. Dhurata-ju po bëni një stadium tek shkolla Suk 1 atje..Eneida-sepse thirrja ishte në këtë drejtim. Dhurata- e para për komunitetin atje, si ajo ska asnjë fushë në Shqipëri se gjen, jo më brenda bashkisë së Fierit, dhe atje vendi po qarkohet me hekura, me gjëra rreth e rreth dhe të mos ketë një ndriçim natën, janë gjithë ato banesa, janë mbi 150 familje në lagjen Agaçaj mos të ketë një panel diellor atje, se nuk u fitoka dot një projekt? Ska një fond të paktën minimal bashkia, z.Maksi tha që e ka. Maksi-janë 50 fotovoltaik, do blihen edhe 100. Eneida-kjo nuk na kushtëzon që ti kemi prioritet për gjatë gjithë vitit. Dhurata-se di mua më duken gjëra të shkruara mbi letër dhe asgjë të zbatuar këtu, se shumica e këtyre është e gjashta herë që po i miratojmë dhe asnjëherë.. Eneida-ne i miratojmë çdo Janar këto. Kryetari- Dhurata dëgjo e nderuar të të shpjegoj diçka në mënyrën si e kam kuptuar unë këtë projekt-vendim. Këto janë gjithë projektet prioritare në bashkinë Roskovec, mos të ngatërrojme ato projekte që kanë tashmë të mundëshme financimin të parashikuar në buxhetin e bashkisë Roskovec dhe kanë marr jetë, pra kanë filluar. Këto janë projekte që do të bëhen, me projektet që do të bëhen bashkia Roskovec administrata e saj aplikon aty ku ka thirrje siç tha specialistja. Dhurata-thirrja nga vjen? Kryetari-Ministri të ndryshme për fusha të ndryshme presin projekte, dhe atje që të çosh një projekt duhet të jetë një projekt i miratuar nga Këshilli përkatës i asaj bashkie ku ti aplikon.. Dhurata-po sa herë i kemi miratuar ? Kryetari-të lutem a mund ta mbaroj? Dhurata-po ska nevojë se unë e di, mos u lodh fare. Kryetari-në qoftë se ti e ke të qartë, kjo listë prioritare nuk tregon që këto projekte do të marrin jetë, këto mund të bëhen dhe të gjitha dhe mund të mos bëhet asnjë sepse është në varësi të faktit nëse projekti me të cilin aplikon bashkia fiton apo nuk fiton. Projektet të cilat nuk kanë arritur që të fitohen dhe të bëhen vitin që kaloi, neve sna pengon askush që të tentojmë që të kërkojmë të gjejmë një financim për këtë vit, unë kështu e kuptoj. Eneida-përsa i përketë pyetjes së tretë për kopshtin, ne kemi një projekt të hartuar dhe kemi aplikuar vjet e nuk e kemi fituar. Bëhet fjalë që të ndërtohet përkrahë shkollës tek ajo sipërfaqja që është e rrethuar, me hyrje të veçantë dhe projekti është gati, thjesht presim hapjen e një thirrje dhe të aplikojmë. Dhurata-mua më duken shpenzime pa kriter. Eneida-është çerdhe-kopsht. Dhurata-çerdhja është tjetër gjë, se çerdhja mund të bëhet tek qendra shëndetsore që po rri bosh, dhe është gjynah të hidhen lekët kot. Maksi-të dyja bashkë ne kemi pasur idenë që shkolla meqënëse u rikonstruktua, u bë palestra, u bë fusha e të gjitha me radhë, atje të jetë dhe një kompleks dhe për çerdhe dhe kopsht, do të ndërtohet nga e para,vendi është. Dhurata-po ndërkohë e ke një z.Maksi, ke një institucion po rri kot ajo godina atje ti e di shumë mirë, dhe duket shumë e bukur nga jashtë se brenda skam hyrë, dhe ajo të rrijë bosh atje? Maksi-nuk është tek Agaçaj, është në Suk 1 tek shkolla. Dhurata-se kam fjalën për në Agaçaj, tek shkolla e kam fjalën edhe unë. Maksi-po u bë një kompleks është më mirë akoma, që të gjitha të përmbliidhen bashkë dhe çerdhja dhe kopshti. Dhurata-nëse bëhet ai kompleksi që thoni atje, i pretë ato 5 drurë që ishin atje, ska as gjelbërim për fëmijët as hije ska më, të rrinë në ajër të pastër, të pastrohet ajri, i pretë ato 5 drurë që ishin atje, atje as 200 m2 skanë mbetur, unë e shoh se kam 30

vjet në atë shkollë atje. Se di e shikoj pa vend këtë ndërtimin e një kopshti. Maksi-po nuk po bëhet sot, ne do aplikojmë në Ministrinë e Arsimit. Dhurata-për çerdhen jam shumë dakort se kam kërkesa dhe nga banorët, duhet të bëhet çerdhja private absolutisht po, por ndërkohë godina është e gatshme atje, mund të bëhet të filloj direkt. Eneida-është çerdhe-kopsht sipas standarteve. Leksi-tek lista prioritare e projekteve kemi dhe Unazën Perëndimore, ka ndonjë thirrje ose ndonjë fjalë andej nga FSHZH a tek ndonjë tjetër, për arsye se me këtë buxhetin vendor nuk e shikoj tek prioritetet një, dhe e dyta sepse ka filluar dhe hedhja në buxhetin vendor për shtrimin e rrugëve si në njësitë vendore dhe në Roskovec. Ka filluar të mbushet me çakull, në gjithë gjatësinë e Unazës Perëndimore do hidhet vetëm në disa pjesë të saj? se ka filluar shtrimi me çakull, tani mos ta paragjykoj përderisa ka filluar shtrimi me çakull do të thotë që do jetë e largët pjesa e investimit të projektit, ka ndonjë thirrje të hapur? Eneida-kemi aplikuar por për arsye se FSHZH në thirrje nuk parashikonte veprat e artit dhe kanale, trotuare, parashikonte vetëm shtresa asfaltme, nuk u pa e arsyeshme që të vazhdonte për arsye se do kishim vetëm bazën rrugore, nuk do kishim projektin e plotë siç e kemi. Ne kemi gati projektin, në momentin që hapet një thirrje do aplikojmë. Leksi-në rast se ai nuk kishte parashikuar veprat e artit, sa vepra arti janë, nuk mund të korrigojohet përsëri ato që parashikonte FSHZH dhe me buxhetin e bashkisë? Eneida-ishte një thirrje e cila nuk na premonte kohën për ta implementuar. Amarildo-bëhet fjalë për një nga pikat e projekteve prioritare që ju keni listuar, shoh që deri diku qëndrojnë realisht të gjitha pikat që keni caktuar, kisha një pyetje në lidhje me rikonstrukcionin e objektit të shkolles 9-vjeçare “Ali Sollaku” në Vidhishtë, nuk e di në çfarë faze e keni, mendoj sepse e keni marr një miratim nga Ministria e Arsimit, do thoja që këtu ka një problem që është aktual për tu zgjidhur. Meqënëse është dhe Maksi ta shënoj, gjendja deri diku është e zgjidhur për pjesën e ngrohjes për kopshtin dhe klasën e parë të cilët ngrohen me dru, ndërsa pjesa tjetër është me energji elektrike por energjia elektrike nuk mban, bie gjithë kohës sahati. Do ju lutesha shumë, është e disata herë edhe herë të tjera e kam thënë të merrni masa sepse nuk ka ngrohje në asnjë klasë përveçse këtyre të dyve që unë thashë, nuk duam të nxijmë çdo gjë kot, kopshti dhe klasa e parë funksionojnë me ngrohje ndërsa pjesa tjetër duhet çuar o një transformator nuk e di është pjesë e specialistëve që duhet ta shikojnë. Dhe diçka tjetër, tek shkolla është një shqetësim që është nga prindërit, duhen vënë disa pengesa sepse rruga është e bërë por kalojnë mjete dhe rrezikojnë jetën e fëmijëve, detyrohen prindërit të lënë punët e tyre dhe i shoqërojnë deri tek shkolla, 2-3 pengesa kjo nuk ka nevojë për të kaluar ndonjë tender, 2-3 pengesa i bëjnë këta zotrinjt e Ndërmarrjes së Shërbimeve, thjesht për të ulur shpejtësinë e mjeteve sepse qarkullojnë edhe adoleshent që janë pa pajisur me patentë por është një gjë që nuk ua ndalojmë neve, ne kemi në dorë të bëjmë këtë. Besoj se kjo do zgjidhet Maksi? Maksi-sa i përket ngrohjes nuk investohet dot për momentin në rrjetin e brendshëm për arsye se rrjeti i brendshëm është i viteve të shkuara, ndërsa sa i përket limitatorit atje, ne kemi rritur sasinë e energjisë që futet por ngarkesa e të gjitha klasave kur ndizen në të njëjtën kohë rezistencat atje, na jep atë që na bie limitatori dhe na digjet edhe rrjeti i brendshëm ndonjëherë. Në rikonstrukcion janë parashikuar të gjitha me ngrohje me kaldaja. Amarildo-ngrohja si do kryhet? Maksi-me kaldaja. Eneida-një grup nga bashkia Roskovec ka marr pjesë në një trajnim të vazhdueshëm për gjatë gjithë vitit nga Unicef, nga ku kemi fituar një projekt të plotë të hartuar nga Unicef sipas standarteve europiane. Aktualisht ne kemi projektin në dorë dhe po presim thirrjen nga Ministria e Arsimit e cila hapet çdo vit në Janar dhe presim punë ditësh që të aplikojmë. Në momentin që hapet, projekti është i plotë me të gjitha detajet, me ngrohje, me ndiçim, me palestër dhe presim të aplikojmë. Maksi-projekti është miratuar nga Ministria e Pushtetit Vendor, ka qënë

dhe vet Ministri me komunitetin, është miratuar projekti tani presim vetëm fondin. Amarildo-ndaj ta bëra këtë pyetje, disa shkolla duke përfshirë këtu shkollën e Zharrzës kanë vendosur dhe pengesa por ka vendosur dhe polic bashkia, gjatë orarit mësimor në shkollën e Zharrzës qëndron polici bashkiak. Maksi-është në rrugë nacionale. Amarildo-por e njëjta rrezikshmëri është edhe aty sepse lëvizin pothuajse në një sens besoj se Kryetari e di, ne kemi një problem nuk lëvizin në të dy senset, në Vidhishtë kanë mundësinë për të kaluar në të dy senset por përdoret gjithmonë pothuajse nga të gjithë shoferët krahu i përroit dhe këtu tani në orarin e shkollës fëmijët rrezikohen sepse realisht makinat ecin mbi normat. Maksi-është kërkesë e ligjshme. Amarildo-kjo duhet zgjidhur. Tjetër një pyetje kisha, është thënë e stërthënë sa herë këtu nga mua dhe nga të tjerë para meje ndoshta, mendoj që përroit të Vidhishtës duhet ti jepet një zgjidhje përfundimtare dhe nuk mund ti jepet një zgjidhje gjithë kohës duke e pastruar, sidomos në këto momente që jemi tani sepse duke mos pasur më ujë se vinte deri para ca kohësh nga rezervuari i Kurjanit, sot është shumëfishuar ndotja në atë përrua. Kanalizime të ujërave të zeza ai fshat nuk ka dhe ujërat e zeza derdhen tek ky përrua, mbi 80% e familjeve mos ta them 100% i derdhen atje se nuk ka as gropa, një pjesë që kalon nga lagja pas por mbi 80% i derdhen aty. Sot që flasim atje nuk ka ujë dhe rreziku për të pasur epidemi është shumë herë më i madh dhe infeksione mund të marrin dhe fëmijët edhe banorët. Do ju lutesha shumë ta shikoni me prioritet sepse nuk mund të vazhdojë më kështu në këtë gjëndje që është, sidomos në këto kushte që jemi sot, në këtë thatësi dhe në këtë pamundësi për ta mbajtur me ujë, sepse duke pasur ujë të rrjedhshëm deri diku e zbut. Maksi-është shqetësim i komunitetit, ka qënë në prioritetet tona dhe mbetet përsëri prioritet për tu bërë, është pastruar..Amarildo-nuk thashë nuk është pastruar Maksi por nuk është zgjidhje. Maksi-nuk është zgjidhje por një nga zgjidhjet që prapë nuk quhet zgjidhje është ndërtimi i stacionit të pompimit në Matkë që do të furnizojë rezervuarin e Kurjanit, ka filluar puna për ndërtimin e tij dhe sivjet ne mendojmë që fermerët do ta kenë vitin e mbarë dhe për vaditje. Amarildo-nuk e diskutoj dëshirën dhe vullnetin e mirë që keni të gjithë, e kuptoj dhe pjesën sepse ajo që të bëhet si projekt ka një kosto të lartë realisht unë e di shumë mirë, por të dini diçka para disa vitesh pa u bërë reforma territoriale, ka pasur një vullnet dhe një projekt për ta realizuar Bankers Petroleum, veshjen komplet me beton anësoret dhe sheshin dhe për të bërë pjesën e gjelbërimit, por emergjente nuk kemi gjelbërimin, kemi veshjen me beton pjesën anësore dhe pjesën poshtë. Besoj se ju keni takime me zotrinjtë e Bankersit, mund ta kërkontë si një financim nga ana e tyre por pa e kërkuar ju ta beni financimin, tua lini në dorën e tyre ta bëjnë financimin sepse këtu qëndron problemi me gjithë bashkitë dhe individët që kërkojnë që kapitalin e tyre ta financojnë bashkitë ose individ të caktuar, ata duan ta kryejnë vet këtë projekt dhe unë e di shumë mirë. Eneida-sa i përket përroit të Vidhishtës ne kemi një projekt të plotë të gjithë përroit të Vidhishtës, pjesës që kalon përmes fshatit. Siç thatë edhe ju kostoja është e lartë dhe për këtë arsye është parë mundësia që ta ndajmë me lote në tre pjesë që të kemi mundësinë për ta realizuar në tre periudha të ndryshme. Amarildo-dhe me lote nuk është zgjidhje. Maksi-jo me lote është zgjidhje, dhe rrugët bëhen me lote. Kryetari-gjithsesi unë do të shtoja këtu faktin që ne duhet të këmbngulim dhe të kërkojmë pranë Ndërmarrjes së Ujësjetës investimin e kanalizimit të ujërave të zeza sepse betonizimi i përroit nuk e zgjidh problemin e ujërave të zeza, përkundrazi mund ta nxjerrë më në..Amarildo-ato do bëhen bashkarisht. Kryetari-kështu që meqënëse diskutojmë për prioritet unë mendoj që prioritet duhet të ishte edhe kjo gjë. Ermira-duke qënë se jemi në listën e projekteve prioritare dhe se jam dhe vet brenda sistemit arsimor, vura re me kujdes që këtu përfshihen tre çështje prioritare në arsim, këto tre çështjet që i përkasin arsimin a i kanë projektet dhe janë aplikuar diku apo thjesht

janë në listën e pritjes? E kam pyetje këtë dhe nëse ka konkretisht një projekt për sistemet fotovoltaike për ngrohje, në cilën godinë të sistemit arsimor të bashkisë tonë? Kam dhe disa sugjerime që e ndiej për detyrim që ta ngre dhe pak zërin. Duke qënë se e kam thënë në çdo mbledhje dhe tani më duket do bëhet e përsëritur, shkolla jonë është rikonstruktuar por palestra ka nevojë që të bëhet funksionale për arsye se parketi i palestrës është shumë i dëmtuar dhe ne e kemi jashtë funksionit atë. A mund të shtohet kjo diku, ku mund të aplikoni juve në projektet tuaja për bërjen e parketit të palestrës, për arsye sepse ajo është e rikonstruktuar muret jashtë dhe brenda por për shkak të parketit ne nuk mund ti çojmë dot nxënësit në ditët me shi që të zhvillojnë lëndën e edukimit fizik brenda palestrës, duke qënë se palestra jonë është një nga tre palestrat që ka qënë ekzistuese që në vitet 90, dhe sot në ditët me shi ajo është jashtë funksionit. E dyta duke qënë se këtu kemi dhe Nënkryetarin dhe më duket se ju e mbuloni dhe fushën e arsimit dhe të godinave të shkollave, të punohet më tepër për oborret e shkollave, ato të jenë të thurura, të sistemuara me kangjella dhe të mos jenë të rrezikshme për fëmijët, të pajiset me stola sepse dhe nxënësit por dhe mësuesit që janë në shërbim dezurn përjashta në oborr, edhe mund të ulen aty, tu krijohen disa kushte minimale dhe bazike. Tjetër gjë janë dhe tualetet, ne vërtet kemi bërë godina që janë funksionale apo me kushte dhe standarte, por ama ato kanë nevojë për tu mirëmbajtur si një shtëpi ku priset diçka, ato duhen riparë herë pas here të jenë funksionale dhe të plotësohen kushtet dhe standartet për tu quajtur tualete funksionale. E kam thënë edhe herën e kaluar kur më është dhënë fjala për problemin e ngrohjes së shkollave, plani të përcaktohet për secilën shkollë ashtu si e ka ngrohjen me lëndën djegëse përkatëse, më takon mua kjo lëndë djegëse hajde ta blejmë që në Shtator-Tetor dhe mos ta lëmë në pikun e të ftohtit, dhe shkolla ta marri dhe ta magazinonjë atje pranë shkollës dhe ta menaxhojmë pastaj vet, se ne nuk jemi që ta marrim sot atë ta përdorim sot, të jemi racional në përdorimin e tyre dhe e dimë shumë mirë, thojë kaq të takon menaxhoje vet, zgjidh ditët dhe që të mos kemi dhe problematika me ngrohjen, duke qënë se i kemi këto ambjente tani, dhe pak duam se shyqyr kemi dhe diellin, na ngroh dhe zoti. Unë e thashë për të gjitha shkollat jo vetëm për shkollën time. Elizabeta-në lidhje me çka foli kolegja Ermira, e ceku për të gjitha shkollat e bashkisë, pak a shumë është i njëjti problem gjithashtu dhe në shkollën tonë qëndrojnë të gjitha ato që Mira ceku, madje kemi pasur edhe probleme me hedhjen e nxënësve nga muret sepse ato janë jo shumë të larta, janë shumë të lehtë për tu hedhur jashtë territorit të shkollës, gjë e cila sjell shqetësim për komunitetin e klasës, për mësuesen dhe drejtorin e shkollës. Drejtoresha në dijenin time ka bërë një kërkesë për rrethimin e murit të shkollës me kangjella. Gjithashtu dhe për lëndën djegëse të kaldajave që tha Mira, që të merren masa për të gjitha ditët e ftohta të dimrit, tualetet të shtohen ato detergjentët, stolat po ashtu të shtohen sepse ne në pushimin e gjatë rrimë bashkë me nxënësit përjashta, për të kontrolluar që të mos ndodhin incidente të natyrave që kemi parë dhe dëgjuar në televizione kohët e fundit. Kryetari-duke ju falenderuar të gjithëve për shqetësimet kaq të drejta dhe të arsytuar që paraqesni në Këshill, do tju kujtoja që ti përmbaheni pak më shumë rendit të ditës, në projekt-vendimet që kemi për të diskutuar, të gjitha këto mundet që ti kishim lënë tek pjesa diskutime në mënyrë që të trajtoheshin veçant dhe mos të devijonim kaq shumë rendin e ditës, pikërisht projekt-vendimin të cilin po diskutojmë, ndaj do të lutesha që shkurtimisht përmbledhtas ti japësh përgjigje për të dyja. Eneida-siç thashë dhe pak më parë, projekti për shkollën “Ali Sollaku” është i hartuar nga Unicef presim të aplikojmë, projekti për kopshtin e Sukut është i hartuar në momentin që do kemi thirrje do aplikojmë, sa i përket sistemit fotovoltaik ne kemi një studim për 10 godina, ku 4 janë godina arsimore shkolla 9-vjeçare Strum, shkolla 9-vjeçare Suk, shkolla 9-vjeçare Roskovec dhe shkolla e mesme Roskovec. Pra

është bërë një studim i plotë për 3 vite nga ekspert mjedisor dhe të energjisë, sesa kanë nevojë shkollat për energji të rinovueshme duke plotësuar nevojat e tyre dhe në momentin që kemi mundësi për të aplikuar, patjetër. Fredi-doja të bëja një pyetje, a po punohet tek diga e liqenit, aktualisht po bëhen punime? Eneida-po, është projekt që ka filluar punimet por momentalisht mund të jetë përgjatë kanalit furnizues, nuk është e thënë që duhet të jetë sesbën tek diga. Fredi-sepse shikojmë këtu rritje e sigurisë së përmirësimit të aftësisë së ujëmbledhësit të Kurjanit bashkia Roskovec një tek pika 7, tek pika 19 rritje e sigurisë së digës dhe përmirësimi i ujitjes së rezervuarit të Kurjanit, pika 27 pyllëzimi i liqenit të Kurjanit, 4 projekte se 1 është aktualisht dhe ska lidhje me këtë, dhe 3 projekte të tjera për ç? sepse ska ujë momentalisht, nuk ka pasur ujë gjatë gjithë këtij viti, as në dimër për të vaditur serat, pse kaq? Eneida-projekti për rritjen e sigurisë së digës është një projekt që sapo ka filluar, është miratuar dhe ka filluar të zbatohet. Aktualisht ka të bëj pikërisht me mbushjen e rezervuarit me ujë. Fredi-është tjetër ajo, ju thatë që po punohet lart jo poshtë. Eneida-jo nuk thashë që po punohet lart, është tjetër projekt ai që po punohet lart. Fredi-bëhen 5 projekte megjithë atë. Eneida-ai projekti për rritjen e sigurisë së digës, është projekt që fillon nga lumi Seman dhe përfundon tek diga e Kurjanit, përveçse rehabilitimit të të gjithë rrjetit, e kemi prezantuar këtë para ca kohësh, qëllimi kryesor është mbushja e rezervuarit me ujë, kurse projekti që po zbatohet aktualisht që janë punonjësit atje, është një projekt i fituar nga FSHZH të cilën ne e zbatojmë me punonjësit e bashkisë dhe kanë marr vetëm lëndën e parë nga FSHZH, dhe pyllëzimi është një projekt tjetër, të cilin pasi të realizohen të gjitha dhe diga dhe sistemimi nga FSHZH, është një fushatë pyllëzimi jo vetëm në Kurjan por në gjithë territorin e bashkisë Roskovec, po ky është një nga projektet prioritare përderisa Kurjani e ka të nevojshme. Fredi-qofsha unë i gabuar dhe mos qëntë ashtu si kam unë informacionin por gojë e liga thonë se dikush ka blerë një biznes aty afër dhe të gjitha këto projekte shërbejnë për atë biznes, nuk ka lidhje fare me këtë, ishalla qofsha unë i gabuar por mesa kam dijeni unë aty po i shërbehet vetëm një biznesi me të gjitha ato projekte, me pyllëzime, me rikualifikim, me shtresat, me trotuare me të gjitha. Ishalla mos qëntë por këtu do jemi do ta shikojmë. Kemi marrja e masave për transferimin e banorëve në fshatin Mbërs gjatë shkarjeve, çka është parashikuar, shpërngulja? Sepse këtu ka një problem që është shpejt, por çka keni parashikuar konkretisht? Eneida-vjet kemi aplikuar me projekte tek Ministria e Financave siç aplikojmë çdo vit për restaurimin e banesave të familjeve në nevojë, kemi aplikuar dhe një projekt për godinë sociale të cilët pretendohej ti strehohim. Fredi-ka lidhje me këtë godinën që është ndërtuar? Eneida-jo është me një projekt të ri, të cilën nuk e fituam dot dhe e njëjta gjë dhe sivjet do përpiqemi që ta çojmë ndërtimin e një godine afër Njësisë Administrative Kurjan. Fredi-ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Ngjeqar, çka është parashikuar këtu, ku është aplikuar se Kryetarja tha brenda këtij viti do marrë rrugëzgjdhje. Maksi-jemi akoma në fazën e pritjes së studimit gjeologjik për puse, jemi akoma në fazën që po bëhet studimi gjeologjik. Vazhdon tani ujësjellësi i Mbërsit, Vloshit dhe Kurjanit ndërsa ujësjellësi i Ngjeqarit duhet të marrim përgjigje nga Instituti Gjeologjik i Tiranës për pusët, shpimin e pusit pastaj të vazhdojmë për vendburimin. Fredi-shikoj që ka linjë përpunimi të perimeve të fushës, të produkteve ndryshe, njësi përpunimi, grumbullimi, laborator i vajit të ullirit, dhe është dhe një diçka tjetër linja e përpunimit të produktit ndryshe, çka do të thotë sepse afërsisht apo janë 3 projekte të veçanta? Dhe ku është parashikuar të aplikohet tek FSHZH, tek grandet apo bashkia vetfinancon? Eneida-linja e përpunimit të produktit ndryshe është thjesht një projekt-ide, nuk kemi akoma një projekt të hartuar të plotë, ndryshe nga njësia e përpunimit, grumbullimit, laborator dhe markimi i vajit të ullirit, i cili ka një projekt dhe pretendohet të bëhet afër Njësisë Administrative Kurjan tek magazina, për të

bërë një agropikë me grumbullimin e vajit të ullirit dhe markimin me logon e Roskovecit, nuk është aplikuar, projekti është gati. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet me 8 vota pro, 4 vota abstenim Dh.Malka,F.Feleqi,A.Hoxha,V.Çepele. Miratohet.

8.Për miratimin e ndihmës për djegien e banesës së Z.Shpëtim Kuqo në fshatin Vidhisht,Njësia Administrative Kuman,Bashkia Roskovec për vitin 2025.

Dr.Ekonomik Selmani-unë doja tju falenderoja për çfarë kemi arritur deri tani, edhe për një bashkëpunim në të ardhmen sidomos në vendimmarrjet që do merren në drejtim të fushës financiare të bashkisë. Natyrisht nuk do mungojë dhe fryma e bashkëpunimit dhe transparencës nga ana e drejtorisë që unë përfaqësoj. Ky projekt-vendim është mbështetur në ligjin e emergjencave civile, në nenin përkatës dhe bën fjalë për dhënien e ndihmës për djegien e banesës së z.Shpëtim Kuqo në fshatin Vidhisht Njësia Administrative Kuman, në masën 215 mijë e 842 lekëve bazuar këto në dokumentat përkatës të mbajtur në bazë të ligjit dhe vendimeve përkatëse të cilat u paraqesim, ftoj miratimin e këtij projekt-vendimi. Dhurata-unë personalisht shpreh keqardhje për familjen e cila është dëmtuar nga djegia, sinqerisht ndiej keqardhje se secilit mund ti ndodhin se janë gjëra, fenomene që si parandalon dot, por kam një kërkesë në lidhje me një banor, ju besoj jeni të mirë informuar. Ne tani diskutojmë dhe miratojmë projekt-vendime në lidhje me këto fondet e emergjencës për ti kaluar këto fenomene natyrore, a ka ndonjë fond specifik sado i vogël qoftë për shëndetin e njerëzve brenda bashkisë, se konkretisht po e kërkoj këtë sepse ju e dini mirë që një qytetar i fshatit Suk 2 Ylli Senka vuan nga një sëmundje shumë e keqe dhe po e bën kurimin vazhdimisht çdo 3 javë ai shkon në Turqi, me një kosto prej 6 milion lekë të vjetra që bën ajo seancë që bën atje kimioterapi i shkreti, dhe ndërkohë ai qarkullon me autobuuz sepse është shumë i rrënuar ekonomikisht, pavarësisht se i gjithë komuniteti është ngritur dhe bravo i qoftë, falenderoj komunitetin të gjithë janë treguar koherent. A ka ndonjë fond mos të zgjatëm shumë, mos të bëhem e bezdisur, a ka ndonjë fond sado të vogël nga brenda bashkisë, dhe të jem e sinqertë vajzat e Ylli Senkës këtij djali unë i kam pasur nxënëse, njëra aktualisht është klasa e shtatë, për 5 vite e kam pasur nxënëse vet, mësuese të përgjërhem më tha kërkoja njëherë Kryetares, të jem e sinqertë kështu më tha vajza. Kryetari-i urojmë të kaluara z.Ylli. Selmani-të paktën nga këto fonde aty nuk përfshihen, nga fondi i emergjencave civile qoftë nga të ardhurat e bashkisë qoftë nga ai i kushtëzuar. Ndërsa në qoftë se do merret ndonjë inisiativë nga ana juaj për një ndihmë të menjëhershme, ndoshta ai kërkon shumë siç e thatë edhe juve me mijëra euro, ishalla ai të ketë shërim të plotë, dhe me një fond që ne do ta shikojmë të arsyeshme dhe në fondet që ne kemi miratuar për këtë vit. Dhurata-do bëhet thua? Selmani-të paraqitet kërkesa dhe të shikojmë pastaj mundësinë. Maksi-po në të njëjtën situatë ne kemi probleme sot në Kuman. Dhurata-problemi i shëndetit të njerëzve bëhet fjalë. Maksi-po shëndeti i njerëzve prandaj po them në Kuman, por janë aq probleme të tilla gjatë një kohe të shkurtër që krijohen në gjithë territorin e bashkisë Roskovec, saqë është e pamundur që Këshilli të merret me këtë. Fredi-një simbolike. Dhurata-po mirë por diçka duhet bërë se gjynah, se janë taksapagues të rregullt të gjithë besoj, të paktën personi është taksapagues i rregullt. Maksi-sipas diagnozes, po dhe ky taksapagues i rregullt, tani nuk dua ti krahasoj se nuk shkon. Dhurata-gjithsecili ka pjesën e vet. Maksi-po gjithsecili ka atë të vetën po janë kaq probleme dhe kaq kërkesa gjatë çdo muaji. Dhurata-po jo Maksi gjatë çdo muaji thotë, ky është rast specifik se ai po vuan me vdekjen. Maksi-raste të tilla sot që flasim bashkë mos ti bëj



publike për arsye se janë bërë publike..Dhurata-po sa janë që thua janë shumë, sa janë? Maksi-janë disa, që nuk kanë të numëruar. Dhurata-caktoje fundja fare të vëmë diçka se gjynah, kemi të bëjmë me jetën e njerëzve. Maksi-duam një diagnozë të përcaktuar që të kemi një kufi deri këtu, o do marrim një kriter ose do vendosim një kriter të caktuar që kujt ti japim 2 milion, kujt ti japim 3 milion, asnjë nuk kënaqet me..Dhurata-po sado pak ndihmë është për ata të shkretët. Maksi-ndaj dhe në faqen e facebookut të bashkisë i kemi hapur këto, edhe punonjësit e bashkisë e kanë dhënë kontributin e tyre. Dhurata-po të gjithë u angazhuam, brenda bashkisë a ka një fond? Maksi- është gjë humane, që do haj diskutim pastaj dhe pakënaqësira. Dhurata-po gjynah se nuk është për të ngrënë bukë, ai do të jetojë. Maksi-do haj diskutime më pas pse ky kështu, pse ky kështu. Dhurata-atëherë cila është zgjidhja se zotria na ndjek tani, çka përgjigje do ti japësh zotrisë? Maksi-tani unë nuk të jap dot përgjigje pozitive për momentin, unë të thashë ha shumë diskutim ky problem për dhënien e ndihmës ekonomike për fatkeqësi në sëmundje. Dhurata-ha shumë diskutime thotë Maksi, ne po themi kemi të bëjmë me jetën e njerëzve. Maksi-po kaq kemi të bëjmë, fondi rezervë që përcaktohet nga qeveria është për fatkeqësitë natyrore. Dhurata-po brenda bashkisë nuk ka fond rezervë? Selmani-po ai është fondi rezervë. Fredi-ne nuk mund të rrimë pa sensibilizuar edhe privatisht por edhe si institucion. Maksi-patjetër, e kemi bërë sensibilizimin jemi plotësisht dakort. Është e pamundur për momentin që ne të themi një shifër, kujt do ti japim kujt sdo ti japim. Fredi-personin në fjalë e kam verifikuar vet, atje ka ndodhur një djegie por për të qënë i sinqertë me ju të bashkisë që keni bërë planin aty, aty 2 milion e gjysëm dyer e dritare nuk ka ndodhur, atje është djegur një dhomë, disa plaçka, ka pasur ose ska pasur plaçka, hajt tja japim por për të qënë i sinqertë 2 milion e gjysëm dyer e dritare si ka ai, se kështu keni bërë zë aty. Maksi-ka një preventiv të përcaktuar. Fredi-e pashë, atij i ka ndodhur djegia, unë kam vajtur në vend i ka ndodhur djegia dhe unë jam dakort, por të paktën tregohuni të sinqertë sepse nuk ka ndodhur aq djegie e madhe, atje është djegur një dhomë e vogël, ka pasur ca orendi brenda, projektin ta kishit bërë jo dyer e dritare vetëm por një dhomë me gjithë orendi vete aty 2 milion e gjysëm lekë, jo dyer dritare se si ka banesa aq. Maksi-po çmimet si përcaktojmë ne, e ka në preventiv. Fredi-po nuk ka dyer e dritare, hajt ta verifikojmë këtë që them unë. Maksi-është manual. Fredi-po manual është, ajo shtëpia që ka ai nuk ka dyer e dritare aq, ska pse ta ekzagjerojmë, jam dakort mbaroi filmi. Maksi-ky është mendimi juaj, ne po themi që kemi preventivin përpara. Nuk ka më pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit të paraqitur dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari-faleminderit dhe për sensibilitetin që keni në lidhje me nevojat e qytetarëve.

9.Për miratimin e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2025-2030.

Kryetari bën me dije se i pranishëm duke ndjekur mbledhjen tonë ka qënë gjithë kohës, me një qetësi të admirueshme z.Robert Murataj nga Bashki të Forta. Sekretarja më thotë që ka pasur dhe një mesazh të vogël për ti dhënë Këshillit, por besoj pak më vonë. Maksi-për pikën 9 ka kaluar nga Prefektura dhe nga Ministria e Pushtetit Vendor, është bërë por nuk ka pse ta bëj unë shpjegimin, duhej të vinte një përfaqësues i Prefekturës se është në shkallë qarku, nuk është në shkallë bashkie kjo pikë, kështu që po qe se ju e shikoni të arsyeshme meqënëse nga Prefektura nuk kanë ardhur përfaqësues, ta shtyjmë për në mbledhjen tjetër. Fredi-mbledhjen tjetër, përderisa ska ardhur mbase ka diçka. Maksi-materjali është por është bërë nga Prefektura, nuk është bërë nga ne dhe është në shkallë qarku. Kryetari-atëherë mund të vij ta relatoj z.Arben specialisti i bashkisë tonë apo do ta

lëmë për në mbledhjen e radhës? Dhurata-si të doni. Amarildo-e kalojmë në mbledhjen e radhës, duhet specialisti të kishte ardhur. Maksi-është në shkallë qarku. Fredi-mbase kanë diçka tjetër ata, shtesë herës tjetër. Kryetari-me mirëkuptimin e të gjithë anëtarëve të pranishëm në këtë mbledhje, pikën 9 të rendit të ditës “Për miratimin e strategjisë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2025-2030” e kalojmë për mbledhjen e radhës.

10.Për miratimin e bashkëfinancimit për programet e strehimit social.

Eneida-sa i përketë miratimit të bashkëfinancimit për programet e strehimit social, për të 8-tin vit radhazi bashkia Roskovec aplikon në thirrjen e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Strehimit, një thirrje përsa u përketë restaurimit të banesave të familjeve në nevojë. Për këtë bashkia Roskovec është 50% bashkëfinancuese me një fond prej 4 milion e 999 mijë e 930 lekë, nga ku fondi total është 9 milion e 999 mijë e 860 lekë me TVSH. Amarildo-nuk është nevoja ta lexosh se e kemi lexuar, materjalin e kemi të gjithë. Do thoja një pyetje, kriteret që janë të përcaktuara se disa nga këto familje më rezultojnë që nuk janë pjesë e shtresave në nevojë, familje që janë në vështirësi ekonomike, ka familje që nuk janë realisht në këtë gjendje. Kryetari-z.Amarildo jemi në pikën 10 për miratimin e bashkëfinancimit, ta ruajmë për diskutim tek pika tjetër. Për këtë pikë e kërkon njeri fjalën për pyetje, diskutime? Eneida-bashkia ka të miratuar në buxhet çdo vit një fond për strehimin social, i cili është i dedikuar për këtë thirrje, e cila hapet çdo vit dhe jemi për të 8-tin vit radhazi fitues. Nuk ka pyetje dhe diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit dhe miratohet unanimit me 12 vota pro. Kryetari-faleminderit të gjithëve që ju jepni mundësi qytetarëve tanë të përfitojnë sado pak nga kjo ndihmë.

11.Për miratimin e listës së përfituesve nga programi “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara”.

Eneida-siç thashë dhe pak më parë, hapet nje thirrje nga Ministria e Financave çdo vit dhe ne marrim një imeil paraprak që do hapet thirrja nga data X deri në datën X, ndërkohë në faqen zyrtare të bashkisë Roskovec ose siç e dini të gjithë sepse po bën vite që është kjo procedurë, nga Janari në Dhjetor bëhen aplikime pranë bashkisë Roskovec nga çdo qytetar. Në thirrjen e Ministrisë së Financave është një dokument reference të cilat do kushtëzojnë disa veprime për përzgjedhjen e familjeve në nevojë. Një ndër to është aplikimi pranë bashkisë dhe aplikimi në sistemin e strehimit, pra është një sistem strehimi të cilën e kanë specialistët për menaxhim, i cili ka po ashtu një sistem pikëzimi për çdo familje nga ku përzgjidhen, por kusht i domosdoshëm është aplikimi gjatë vitit pranë bashkisë Roskovec, pra nuk mund të ketë aplikuar dikush para 5 vitesh dhe të pretendojë të jetë fitues. Ngaqë kërkesat kanë qënë të shumta dhe ne e kemi pasur të kufizuar sepse nuk mund të restaurosh me 2 milion lekë të vjetra një banesë, është parë e arsyeshme që të paktën një person në fshat të jetë. Amarildo-meqë ju thoni që kemi patur shumë kërkesa, sa është numri i aplikimeve? Eneida-nuk kam një numër fiks sepse i ka..Amarildo-ok,tani ju thoni që i keni përzgjedhur nga një person në fshat, si është bërë përzgjedhja e këtij personi në fshat, sepse ju thoni që aty ka vërtet disa persona të tjerë që kanë aplikuar dhe i plotësojnë kriteret si ai personi, për mos ti përmendur emrin askujt këtu se ndoshta të gjithë kanë nevojë për ndërhyrje, por tani kjo është bërë e njëanëshme përzgjedhja, si? Kush e ka vendosur këtë personin që ky është më nevojtari? Duke qënë se atje mund të jenë 4 me të njëjtin problem për restaurimin e

një banesë, por atje është përzgjedhur 1, kush e ka vendosur? Eneida-pasi bëhet aplikimi pranë bashkisë Roskovec, ngrihet një grup verifikimi në terren i cili shkon tek çdo banesë dhe bën verifikimin e banesës, ndërkohë për çdo aplikim është edhe një grup tjetër në bashki i cili bën verifikimet sociale, pra sa persona janë në çertifikatë familjare, sa persona banojnë, sa marrin ndihmë, kemp dhe të gjitha këto bashkohen dhe përzgjidhet një. Amarildo-në rastin në fjalë për rikonstrukcionin e banesave ose për nevoja të tjera që kanë këto kategori vulnerable, do ju lutesha shumë të keni bashkëpunim dhe me Kryetarin e fshatit dhe me pleqësinë, sepse shoh nuk dua ti përmend emrin, të pakten në Njësinë Administrative Kuman ka njerëz shumë më nevojtar se disa persona që janë këtu realisht dhe përzgjedhja duhet të bëhet mbi bazën e atyre që janë në nevojë, atyre që janë vërtetë në nevojë imediate, sepse e thashë edhe njëherë ndoshta realisht nuk i keni mundësitë për ti rikonstruktuar të gjitha këto banesa, por mos bëni diferencime. Nuk është nevoja ti hyjmë politikës këtu për të bërë këto investime të vogla, por bëni ata persona që vërtet janë më në nevojë. Maksi-Amarildo për të qënë transparent, ka një komision të strehimit në bashki dhe komisioni i strehimit mbledhet së bashku me të gjithë Kryetarët e fshatrave, janë mbi 70 kërkesa që janë regjistruar gjatë vitit 2024. Ky komision pasi shikon dhe verifikon të gjitha kërkesat e paraqitura gjatë vitit 2024, për tu futur në projektin e vitit 2025, selekton sipas kriterëve që thamë. Pas selektimit mbledhet komisioni përsëri me Kryetarët e fshatrave dhe ka përcaktuar nga 2-3 nga çdo fshat për shtrirje gjeografike, për ti dhënë shtrirje gjeografike këtij problemi kaq të rëndësishëm dhe vendosin që në bazë të fondit të përgjithshëm, i cili është rreth 50 milion lekë nga bashkia dhe 49 gjysëm për gjysëm nga shteti, ky fond i tërë mund të jetë deri në 16 shtëpi për të ndërtuar. Ne mund të bëjmë një ndarje gjeografike, Roskoveci do të ketë pak më tepër se është qytet më i madh dhe çdo fshat të ketë nga 1 familje duke marrë e padiskutuar dhe mendimin e Kryetarëve të fshatrave, dhe kemi marrë nga 2-3 numër të caktuar të familjeve që janë më në nevojë. Komisioni pastaj që është drejtoresha e verifikimit në terren dhe planifikimit të preventivave për të mbyllur gjithë procesin, ka vajtur shtëpi më shtëpi dhe i ka verifikuar në çdo fshat. Përfundimisht duke parë dhe gjendjen e rrënuar të shtëpive kemi vendosur pastaj nga një për çdo fshat. Proçesi ka qënë më shumë se transparent dhe Kryetarët e fshatrave kanë qënë prezent së bashku me komisionin e strehimit. Mund të ketë edhe të tjerë, jo mund por ka plotë të tjerë, ne kemi verifikuar nga 2-3 në çdo fshat, kemi vendosur nga 1 pastaj se kaq është mundësia financiare. Dhurata-unë e shoh që në Njësinë Administrative Strum janë 6, secila nga këto familje sa përfitojnë afërsisht?sa u bie të marrin afërsisht? Maksi-sipas nevojës është bërë preventivi. Eneida-fondi është 100 në total, 50 është nga bashkia dhe 50 është nga Ministria. Maksi-i bie nga 5 deri në 10 sipas nevojave që kanë, gjithmonë të vjetra. Elmazi-duke pasur këtë listë përpara,unë shtroj një pyetje, për njësinë Strum sa kërkesa ka pasur, për Roskovecin sa kërkesa ka pasur, për njësinë e Kumanit sa kërkesa kanë qënë, dhe për Kurjanin? Dhe si është bërë përzgjedhja e tyre? Duke dëgjuar dhe Nënkryetarin aty, mua më rezultoi se ka dhe më keq se këta që janë këtu, po deshët i jap me fakte këtu në Këshill, prandaj kush është ai në krye të këtij komisioni që ka verifikuar vendin dhe këta qenkëshin keq, të dy që janë të bashkisë Roskovec. Maksi-të njësisë Roskovec se ka dhe Jagodinën. Jagodina është pallat që të jemi korrekt, është tarraca e pallatit të vjetër të Jagodinës, është bërë vjet në mos gaboj nga ky Këshill, është bërë njëri pallat me çati, sivjet menduam që të bëjmë pallatin tjetër për mos ti ndarë në familje të veçanta, do bëjmë gjithë pallatin. Elmazi-dua të di si anëtar i Këshillit sa kërkesa ka në bashkinë e Roskovecit, dhe a janë verifikuar nëpër shtëpi apo jo? Se nuk janë verifikuar, unë them që nuk janë verifikuar. Maksi-unë them që janë verifikuar. Elmazi-jo, nuk janë verifikuar. Maksi-Kryetare e komisionit të verifikimit

dhe vlerësimit ja ku është këtu, dhe do të kthej përgjigje për çdo person. Elmazi-ka qënë tek familja e Rushan Çepele, ka qënë në atë objekt? Atje nuk rri dot brenda. Maksi- ai personi që kemi diskutuar bashkë është? Elmazi-po. Maksi- i është dhënë komisionit është verifikuar, ndërsa ky Spiro Kola është dhe invalid pra plotëson kushtin që është dhe invalid dhe është i pamundur për të bërë ai vet ndërtim dhe e kemi lënë për herën tjetër, ishin në të njëjtin nivel, kam qënë për verifikim tek të dy. Leksi-unë kam një rast specifik në të cilin ai ka dal përfitues për të përmirësuar kushtet e banimit në banesën që kishte atje vet, ashtu e vlerësoi dhe komisioni por në momentin që erdhi u pa atje, nuk u investua sepse shtëpia ishte fare e degraduar dhe nuk mbante asnjë lloj gjëje. Tani në këto kushte qytetari pse duhet ta humbasi të drejtën që tek ajo shtëpi të investohet, çka kriteri kishte që këtë e skualifikoi? Feti Sollaku e kishte fituar ai të drejtën, vajtën e panë..Maksi-nuk kishte fituar, ai u planifikua për tu verifikuar. Leksi-jo, u verifikua dhe fitoi, pastaj doli që nuk investohet për arsye se nuk mban fare shtëpia. Maksi-ai 5 milionshi nuk bëhet nga themelet shtëpia deri lart. Leksi-nuk ka më që të bësh shtëpi nga themelet, ska? Po me 5 milion nuk mund të rregullohej diçka atje? Maksi-jo se nuk mbante muri. Eneida-thirrja është përmirësimi i kushteve të banimit, nuk pranojnë as banesë nga e para as themele, mund të bëhet ndonjë shtesë e vogël ose çati, gjithmonë duke patur orientimin e përmirësimit të kushteve. Leksi-në këtë vlerë 5 milion nuk ngre dot 1 dhomë? Eneida-si emër nuk e kam të dëgjuar si listë përfituese, se të paktën ata që janë në listën fituese janë pak emra dhe mbahen mend. Fredi-këta janë shpërndarë janë 17, dhe përpjestim nga 100 për 17 apo prapë kalojnë në komision këta çka do jepet, apo kanë kaluar sa do i jepet 1, 2, 17 ? E dyta unë dyshoj tek përzgjedhja sepse në fshatin Ngjeqar janë edhe 2-3 familje të tjera që janë, edhe janë shumë keq. Është Ushtar Shabani, ai është njeri pa njeri, ai është më vetë, ai është me të meta, ai është me probleme shëndetësore që është problematik. Është një Kastriot Zeka, është hallexhi në ditë të pikës dhe do ishte më mirë sepse për mendimin tim që unë di diçka më shumë se të tjerët, unë e paragjykojë procesin dhe jam i bindur që përzgjedhja është bërë vetëm politikisht, për të përfituar politikisht dhe për të bërë pazar për votat. Unë shpreh atë që ndiej dhe 99% e kam të vërtetë, po të ishte se e kishit sinqerisht në fshatin Ngjeqar janë 4 familje, në qoftë se duhet të ishit me komunitetin ose me Këshillin që të bëhet, të vizitohen të katërt për të mos prishur qejf asnjërit, në fshatin Ngjeqar do hidhet një short..Elmazi-me short nuk bëhet ajo.Fredi-po mirë mendimi im o Elmaz, unë nuk të ndërpreva nuk të dhashë mendim, që të bëhemi të besueshem. Maksi-ke vajtur tek të katërt këto familje për ti verifikuar? Fredi-po mbase dhe skanë vajtur, ke vajtur tek Ushtar Shabani? Eneida-kemi vajtur tek Kastriot Zeka. Fredi- ore tek Ushtar Shabani, unë sdua ti marr rast pas rasti, pse skeni vajtur ju? Se e dini që Ushtari është i vetem, Ushtari nuk ka asnjë mbështetje, Ushtari nuk ka vota, dëgjo nuk keni vajtur. Kjo që them unë është e vërtetë dhe është e saktë. Maksi-për mendimin tuaj. Fredi-për mendimin tim unë spo them mendimin tënd, mendimi jot është ndryshe pavarësisht se sinqerisht ti do kesh mendimin tim dhe do biesh dakort me atë që them unë. Në qoftë se jeni të sinqertë dhe në qoftë se do bënim atë vepër për të mos pasur qejfmbetje, për të mos pasur paragjykime, në mes të fshatit ose në bashki, merre këtu ti se ke shumë frikë nga transparenca atje në mes të fshatit. Maksi-nga transparenca skam frikë unë. Fredi-këtu në bashki të hidhen të gjithë, 17 veta aplikojnë 80, të shikohen ata në qoftë se sjanë të 80 mos të aplikojnë ata fare për këtë proces, të pritët viti tjetër. Ata që janë përzgjedhur 70 veta, të gjithë familjet të hidhet një short, ska pse ta kundërshtojë asnjëri, fitojmë besimin e qytetarëve. Të jeni të bindur ju që kështu jeni paragjykuar dhe vitet e tjera, kështu jeni paragjykuar se nuk rezultoi ndryshe, njerëzve që nuk u takojnë, jo për personin në Ngjeqar, Ushtari është pa bukë, është pa njeri fare, është më keq. Maksi- ore personi që është në listë..Fredai ai po them është pazar votash,

në të gjithë 17-çen. Eneida-unë kam qënë tek Kastriot Zeka dhe mbaj përgjegjësi profesionale për strukturën e shtëpisë së Dragot Vidhishta si banesë. Fredi-ata emergjente janë të gjithë. Eneida-ekzakt, kështu që sido që të jetë njëri do bëhet këtë vit, njëri vitin tjetër deri sa të mos kemi më emergjente. Fredi-Ushtar Shabani aplikon shumë vite dhe nuk e bëjnë, pse se bëjnë? Është më hallexhi. Maksi-do shtëpi apo do riparim shtëpie Ushtar Shabani? Fredi- është riparim, do 5 milion lekë, 6 milion lekë hajde ti gjejmë, jepi 3, ndaua të dyve nga 3, ti bëjmë të dy të rikonstruktueshëm.Eneida-nuk mundet. Fredi-nuk mundet se doni vota, është para zgjedhjeve. Maksi-nuk janë bërë për vota por janë bërë ata që janë më keq. Eneida-preventivat bëhen sipas një manuali zyrtar dhe ne nuk dalim dot mbi manualin. Fredi-llafollogjira ka plot. Eneida-jo është ligjor, është manual zyrtar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe ne nuk dalim dot nga preventivat, dhe preventivat me ato volume që ai ka nevojë, nuk shkojnë në 3 milion, shkojnë madje më shumë sesa mundemi ne. Amarildo-nuk kemi asgjë kundra për pjesën tuaj dhe institucionale si bashki dhe profesionale, për të mos patur debate të tilla një sugjerim kisha, herë të tjera ne të Këshillit, këtu jemi dy përfaqësues dhe të opozitës dhe të mazhorancës, në momentin që specialistët do shkojnë në terren për verifikimin e këtyre banesave, do sugjeroja në rast se do ishin dakort të gjithë, në njësitë administrative përkatëse të ketë përfaqësues nga Këshilli Bashkiak, së bashku dhe me kryeplakun e fshatit. Idea është të ketë përfaqësues, ne nuk jemi specialist por ne dimë realisht kush janë më në nevojë, apo jo? Kryetari i Këshillit besoj se bie dakort tek kjo pjesë, që ne zonën tonë e njohim mjaft mirë dhe i dimë familjet që janë më në nevojë, tani për mos ta bërë që të themi jo e mori ky jo e mori ai, jo ky i majtë jo i djathtë, të jetë më transparent. Maksi-pjesmarrja juaj është e domosdoshme nuk ka nevojë për koment. Amarildo-pikërisht, të jetë përfaqësues nga Këshilli Bashkiak së bashku me specialistët. Dhurata-në varësi të zonës. Amarildo-që mos të ketë konflikte dhe debate të tilla, sepse bie plotësisht dakort që aty realisht ata janë nevojtar, nuk thamë që sjanë nevojtar, por ha debat kjo punë se janë pak a shumë të gjithë në një nivel këta që kanë nevojë për ndërhyrje, atëherë do ishte një rrugëzgjdhje kjo, mendimi im, kaq kisha faleminderit. Kryetari-unë e gjej me vend sugjerimin sepse ne përfaqësojmë komunitetin dhe pse mos të jemi pjesë e vendimmarrjes, nuk do doja fare ta politizonim këtë çështje kaq të thjeshtë dhe që është për disa njerëz në nevojë, pasi unë në fakt po ti futesha llogjikës së politizimit, kjo mundësia që ne diskutojmë këtu hipotetike që bëhet për vota, i bie që unë kam marr 1 dhe kam humbur 3 se ishin 4 gjithësej ata. Pra nuk do doja që ta politizoja, kështu që nuk do doja fare që ti futeshim këtij lloji debati, se thashë fitimi kur merr 1 dhe lë 3 nuk qëndron as matematikisht. Faleminderit dhe e gjej me vend gjithë propozimin dhe arsyetimin tuaj në lidhje me momentin e përzgjedhjes. Fredi-në vazhdimësi të propozimit të z.Amarildo dhe tuajit që e mbështetet, ne kemi një ndërtesë sociale për strehim, mos të na shpëtojë përshembull që të bëhen pjesë përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak, të bëhen pjesë e komisionit, propozim.Nuk ka më diskutime. Kryetari hedh në votim projekt-vendimin sipas materjalit dhe miratohet unanimisht me 12 vota pro. Kryetari-një falenderim për të gjithë ju që mbështetet këtë nisëm kaq të rëndësishme komunitare dhe me urimin që të përmirësojmë sa të mundemi jetën e këtyre qytetarëve, ju falenderoj të gjithëve për gjithë vendimmarrjet e sotme. Fredi-kisha dhe një propozim për këtë djalin, ne kemi miratuar shumë gjëra, miratojmë dhe një kamer se po rri me telefon në dorë ai. Bashkia e Fierit ka miratuar 8 milion lekë materjale, të miratojmë një fond të veçantë që mos të rrijë ai me telefon në dorë.

12.Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Dhurata-të gjithë e dimë që Ministria e Bujqësisë ka çuar një fond për gjithë fermerët, kryesisht për ata që merren me prodhimin e serave. Tani këta fermerët që ta përfitojnë këtë fondin duhet domosdoshmërisht të plotësojnë ca kritere, të plotësojnë ca letra. Në kohën që këta fermerë shkojnë për të aplikuar, u dalin shumë pengesa përpara. Pikë së pari pengesa e parë është kjo që duhet të paguajnë tarifatat dhe taksat që janë caktuar nga bashkia. Një fermer më ka sjellë një faturë tek shtëpia, këtu thotë taksë toke, taksë kanali, taksë ndërtese, taksë trualli, taksë pastrimi, taksë gjelbërimi dhe takse ndriçimi dhe thotë në Njësinë Administrative Strum 70% e banorëve nuk e përfitojnë as taksën e gjelbërimit as taksën e ndriçimit, këtë e dimë të gjithë mirë. Tani pse këta fermer se këta duhet të aplikojnë 2 herë në vit, një sezon 6-mujor këta do aplikojnë pranë zyrave në Fier për të përfituar këtë fond në lidhje me aplikimin për fondin për subvencionim për farishtet që marrin për serat, se ne e dimë shumë mirë që 70% është bujqësi dhe kryesisht janë mbjellë sera, të paktën zona e Sukut-Strumit poshtë. Në kohën që vijnë në bashki u kërkohet kjo taksë, ata e paguajnë të shkretët, do thoni ju nuk është ndonjë tarifë e madhe se 5 mijë lekë është ndriçimi, 5 mijë lekë është gjelbërimi. Kjo ndodh çdo 6 muaj, 10 mijë lekë për 1 familje çdo 6 muaj, i bie 20 mijë lekë të vjetra secila familje për gjithë vitin. Maksi-2 nga 5 bëjnë 10. Dhurata-2 nga 5 bëjnë 10, po 2 sezona bëjnë 20 sepse aplikojnë dy herë fermerët, aplikojnë dy sezona për të fituar këtë subvencionim të farishteve. Pse të paguajnë këtë taksë këtu kur ndërkohë që skanë shërbimin? Kryetari-në qoftë se e paguan një herë tarifën, ti merr vërtetimin që e ke paguar, se paguan dy herë. Dhurata-po pse ta paguaj kur ai se ka këtë shërbim, pse e paguajnë këta të shkretët fermer këtë, se po nuk e paguan këtë ata stë japin letër këtu në bashki, as Njësia Administrative Strum nuk japin hiç po spagove këtë taksë, ndërkohë skanë as gjelbërim as ndriçim pse do paguajnë? Ndërkohë edhe radhën e vjetshme kemi miratuar që të vijnë të bëjnë një aplikim këtu pranë bashkisë dhe këta hiqen nga regjistrimi, pse do vijnë këta të aplikojnë këtu për tu hequr nga regjistrimi, nga sistemi gjoja, kjo që e futi në sistem smund ta heqi vet këtë? Maksi-jo, pa vendim Këshilli nuk hiqet. Dhurata-po pse e fute more zotri, konkretisht ska ndriçim, pse e futët? Çfarë po ndodh këtu, se kjo është zhvatje, kjo është padrejtësi që u bëhet gjithë fermerëve se gjynah. Maksi-ekzekutivi zbaton vendimet e Këshillit Bashkiak, në KB paraqiten projekt-vendimet dhe në projekt-vendimin e paraqitur për taksat dhe tarifatat vendore nuk janë përjashtuar këta fermerë që thua ti. Ne kemi thënë në ato vende që nuk ka shërbime, po me një vendim Këshilli Bashkie duhen përjashtuar. Fredi-këtë e kërkova, e mban mënd e kam kërkuar. Dhurata-po pse se keni bërë? Maksi-në rastin konkret është në rregull me vendimin e Këshillit Bashkiak. Ndërsa sa i përketë kërkesës për të bërë kërkesë më tej, kemi kohë për ta diskutuar. Dhurata-po çka kohe kemi fermerët do aplikojnë se duan të marrin subvencionin e farishtes. Maksi-po jo çdo fermer pse ju vjen kjo letra tani ta heqim nga taksat. Dhurata-çdo familje në Suk është me sera, çdo familje do paguajë taksë ndriçimi, gjelbërimi, pse spo them për pastrimin. Maksi-tani taksat dhe tarifatat vendore do na kërkoni llogari pastaj, pse su realizuan taksat dhe tarifatat vendore. Dhurata-të lutem, ky shërbim nuk është në komunitet, pse do paguhet? Maksi-është në vendimin e Këshillit të Bashkisë. Kryetari-vendimi nuk parashikon marrjen atje ku nuk ofrohet shërbimi. Dhurata-kjo është zhvatje e hapur, kjo është e turpshme, kjo është e patolerueshme, merreni me tallje ndoshta por unë flas në emër të gjithë komunitetit dhe shumë shpejt do ketë protestë në lidhje me këtë, se kjo është zhvatje e drejtëpërdrejtë. Kryetari-vendimi i Këshillit nuk parashikon marrjen e tarifës atje ku nuk ofrohet shërbimi. Dhurata-por është shqetësim ama që duhet zgjidhur absolutisht menjëherë. Leksi-meqënëse jemi në pikën e fundit, kisha një shqetësim të qytetarëve për pjesën që të marrësh një vërtetim vendbanimi do një kohë relativisht 3 ose në rast se nuk firmoset nga Kryetari mund të

zgjas dhe 1 javë, në rastin kur nuk është Kryetari mund të zgjasi dhe 10 ditë, kur atyre u duhet urgjentisht o 1 ditë ose i duhet brenda ditës. Nuk ka mundësi që ti çlirojmë çik ? Ai merr vërtetimin e taksave aty dhe të KUZ-së, pastaj duhet të kalojë shkresa tek Dr.Ardhurave Vendore, nga Dr.Ardhurave Vendore do vej në protokoll, nga protokollin duhet të vej tek sekretarja, sekretarja do ta çoj për konfirmim tek Kryetarja, do dali prapë nga zyra e Kryetares do vej përsëri atje poshtë do protokollohet, pastaj kthehet prapë tek Kryetarja të marri firmën dhe vulën. Maksi-me vendim të Këshillit të Ministrave përgjigjet e shkresave janë brenda 3 ditësh, në rastet specifike të veçanta të paktën unë në pozicionin e Nënkryetarit, edhe brenda ditës ne kemi kthyer kur ka problematika të veçanta. Brenda 3 ditësh është e detyrueshme për arsye se shkresa do protokollohet, do vej për verifikim në Drejtorinë e Taksave, në Drejtorinë e Bujqësisë..Leksi-a e mori poshtë vërtetimin që nuk ka detyrime, pse duhet të venë kot përsëri lart, të zbresi prapë tek protokollin poshtë, të vej dhe ta siglojë Kryetarja, të dali prapë jashtë. Unë kam qënë prezent në këtë se ai donte të lidhte ujin dhe ka 1 javë që është marr me këtë punë. Maksi-me ligj është 3 ditë, nuk ka asnjë 1 javë apo 10 ditë. Leksi-unë kam qënë dhe vet prezent se ai donte të lidhte ujin dhe 1 javë është marr me këtë punë. Maksi-po nuk ka shanse 1 javë. Leksi-po 1 javë se kam qënë vet i pranishëm. Fredi-tregon faturën, këtu shihet qartë që gjysma janë taksa dhe gjysma tarifa, është pikërisht ai vendimi i Këshillit Bashkiak që kam kërkuar të përcaktohet fiks, mos vjelja e tarifave atje ku nuk shërbehet sepse është vjellje, është e kundraligjshme, dhe ju thatë nuk ka nevojë ta përcaktojmë sepse e parashikon ligji, por ja që paska. Unë edhe vjet e kam paraqitur kunatin tim, ato bizneset aty nga dalja e Roskovecit deri tek vreshti i Roskovecit që nuk kanë drita, për tekat për huqet e asaj se si dhanë njëherë votën Kryetares dhe tha sa të jem unë nuk ua çoj dritat, dhe vjeljen e ndriçimit e bën tarifën, se ato janë biznese janë të detyruar të paguajnë tarifën dhe ndriçim skanë. Kjo është vjellje, tarifa atje ku nuk shërbehet është vjellje dhe u bëj thirrje qytetarëve të mos paguajnë tarifa atje ku nuk shërbehet. Maksi- dhe unë u bëj thirrje qytetarëve të zbatojnë vendimin e Këshillit të Bashkisë. Fredi-e kupton sa me hile e ke pasur, që ska nevojë the. Maksi-nuk ndahen taksat dhe tarifatat se smund të çojmë 2 fatura. Fredi-jo jo, tarifatat në qoftë se nuk shërbehet më thuaj, kjo është tarifë ku nuk shërbehet o zotri. Maksi-është tjetër gjë ajo. Fredi-si është tjetër gjë? Maksi-të lutem, me vendim të Këshillit të Bashkisë..Fred-si me vendim të Këshillit të Bashkisë, the nuk ka nevojë se doje të vilje më shumë lekë. Nuk ka më diskutime. Kryetari-atëherë të nderuar këshilltar unë e deklaroj këtë mbledhje të mbyllur. Faleminderit për gjithë diskutimet, për gjithë shqetësimet, për votimin e sotëm, të gjithëve faleminderit.

Sekretar

Arlinda Hajdini

Kryetar

Afrim Plaka